

Datë 14.07.2024

## NJOFTIM

### DREJTUAR:

1. Punonjësve/Ish-Punonjësve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi
2. Kreditorëve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi
3. Debitorëve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi

### OBJEKTI:

1. Njoftim për depozitimin e pretendimeve dhe të drejtave të siguruara mbi pasuritë e debitorit Brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga shpallja e këtij njoftimi
2. Kërkesë debitorëve për pagimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k prane administratores se falimentimit.

### Të nderuar,

Shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k me NIUS L41726002A ka shpallur falimentimin, sipas Vendimit të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Nr. Akti 8762 , date 04.03.2024 duke me emeruar mua, Znj. Shpresa Breçani si Administratore Falimentimi për këtë shoqëri.

Nën cilësinë e administratores së falimentimit jam urdhëruar nga Gjykata për të depozituar vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit të shoqërisë prane institucioneve perkatëse.

Gjithashtu bazuar në pikën 3, 4 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Nr. Akti 8762 , date 04.03.2024 njoftohen kreditorët e shoqërisë në procedurë falimentimi “Besa Agro Invest” sh.p.k të paraqesin pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga shpallja e këtij njoftimi.

Gjithashtu personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë në procedurë falimentimi “Besa Agro Invest” sh.p.k duhet t'i paguajnë dhe shlyejnë ato prane administratores se falimentimit.

***Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,***

**Me respekt,**

**Shpresa BREÇANI**

**Administratore Falimenti**

**Licence Nr. 9**

